



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGETARE

URDHER

Nr. 904 Date 4.122007

PER DEPOZITIMIN E STATUTIT TE
SH.A. " UJESJELLES KANALIZIME" PEQIN

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1. Depozitimin e statutit te ndryshuar te shoqërisë Sh.A. " Ujësjetllës Kanalizime" Peqin.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.
Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



STATUT
I
SHOQERISE ANONIME

NENI 1
Emertimi dhe selia

Shoqeria anonime krijohet nga transformimi I ndermarrjes shteterore
"Ujesjelles " Peqin
Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet: "Ujesjelles " sh.a Peqin.
Selia e shoqerise eshte ne adrese : Peqin

NENI 2
Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:
Prodhim dhe furnizim me uji te pishem qytetin Peqin, si dhe fshatrat Karine,
Gjocaj, Trah, Karthnek Sheze, dhe Pekisht.
Shoqeria brenda caqeve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi. do te kryeje
çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejteperdrejte ose terthorazi me
objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e
shoqerive te reja, si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera jashte
vendit.

NENI 3
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar I shoqerise 50.600.000 leke. Numri i aksioneve eshte
50.600 Vlera nominale e aksionit eshte 1000 leke.Ne kapitalin themeltar nuk
eshte perfshire vlera e truallit , gje qe do te behet ne nje kohe te dyte .



NENI 4

Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi

Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me Urdher te Ministrat te Ekonomise Publike dhe Privatizimit ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

NENI 5

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- 1) Keshilli mbikqyres
- 2) Drejtoria

NENI 6

Keshilli Mbikqyres

- Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare. Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit.
- Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 (kater) vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjitha te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura.
- Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.
- Ne se nje ose disa vende te anetareve te keshillit mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3 (tre) muaj. Anetari i keshillit mbikqyres i emeruar me zevendesim te nje anetari tjetere, perfundon mandatin e paraardhesit..
- Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 (gjashtedhete e pese) vjeç nuk mund te jene me shume se 1/3 (nje e treta) e numrit te pergjithshem te keshillit mbikqyres. Ne se ky raport tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

NENI 7

Kryetari dhe zevendes kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar, te cilet therresin mbledhjen e keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjithë kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar edhe jashte anetareve te tij.

Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit, mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari.

NENI 8

Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendes kryetarit. Kryetari duhet te therrase mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 (pesembedhete) diteve kur drejtoria ose 1/3 (nje e treta) e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere anetaret mund te therrasin mbledhjen e keshillit mbikqyres, duke i percaktuar rendin e dites. Ne parim thirrja duhet te behet 3 (tre) dite perpara, me leter, telegram, teleks ose fax. Por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me goje dhe pa afat ne se anetaret e keshillit mbikqyres do ta pranojne ate. Çdo thirrje duhet te percaktoje rendin e dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te percaktuar ne thirrje. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem vetem ne se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem, ne rast barazimi votash, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari ose zevendes kryetari.

Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zevendes kryetari i keshillit mbikqyres.



NENI 9

Kompetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershëm per administrimin e shoqerise nga drejtoria dhe i jep kesaj te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli mbikqyres emeron drejtorine. Keshilli mbikqyres cakton njerin prej anetareve te drejtorise me cilesine e drejtorit.
- Me emerimin e anetareve te drejtorise keshilli mbikqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise.
- Keshilli mbikqyres autorizon drejtorine qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te statutit.
- Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrole qe ia i çmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshëm per permbushjen e detyres se tij.
- Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Keshilli mbikqyres i propozon Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit lidhur me keto çeshtje :
 - a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.
 - b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
 - c) Hapjen e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
 - d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshëm te shoqerise.
 - e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesmarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.
 - f) Marrjen e huave afatmesme, afatgjata.
 - g) Si dhe per çdo çeshtje tjeter qe ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjitheshme



NENI 10

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

NENI 11

Drejtoria

- Shoqeria administrohet nga drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare Numri i anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij.
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjithe anetareve te ketij keshilli.
- Anetaret e drejtorise jane persona fizike, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Ata mund te zgjidhen dhe jashte te punesuarve ne shoqeri. Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar drejtores ose drejtor ne me shume se nje shoqeri. Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i anetarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.
- Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe prej 4 (kater) vjetesh. Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura, keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.
- Anetaret e drejtorise jane te riemerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 (gjashtedhete e pese) vjeç. Anetari i drejtorise qe mbush moshen 65 (gjashtedhete e pese) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre.

NENI 12

Kompetencat e drejtorise



- Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.
- Ne marredheniet me te tretet shoqeria merr persiper detyrime qe rrjedhin nga aktet e drejtorise te nenshkruara nga anetari me cilesine e drejtorit edhe kur keto e tejkalojne objektin e veprimtarise se shoqerise, pervec rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorise kapercente objektin e veprimtarise se shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt, duke pasur parsysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.
- Aktet me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruben nga anetari me cilesine e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem kur jane prezent jo me pak se gjysma e anetareve te saje. Ne rast barazimi votash, vota e anetarit te caktuar me cilesine e drejtorit eshte percaktuese.
- Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlere mbi 2 (dy) milion leke behet me autorizim te keshillit mbikqyres.
- Marredheniet brenda shoqerise percaktohen me rregullore qe miratohet nga keshilli mbikqyres.

Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise te cilen e miraton keshilli mbikqyres.

NENI 13

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe drejtorise ose te nje anetari te keshillit mbikqyres

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe anetereve te drejtorise ose nje anetari te keshillit mbikqyres, qofte e drejteperdrejte ose jo e drejteperdrejte duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Percaktimi i mesiperm eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nje anetar i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te nje shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshje. Kjo nuk eshte e zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale.

Anetari i drejtorise ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohet kerkesat e ketij

neni te statutit. Anetari i interesuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

NENI 14

Eksperti kontabel i autorizuar

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga 1,(nje) eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga aksionmbajttesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

NENI 15

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar deri me 31 Dhjetor.

NENI 16

Inventari -llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitetit t e rregullt te pasurise dhe te vperimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbylljen te ushtrimit, drejtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

NENI 17

Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem. Nga fitimet e ushtrimit, te paksuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 % (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme.

Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje arsye çfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjetat) e kapitalit.



Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

NENI 18

Emerimi i anetareve te pare te keshillit mbikqyres

Si anetare te pare te keshillit mbikqyres

Z.Hektor Bejko.

Zj.Flutura Hoxha

Z. Bledar Dervishi

NENI 19

Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar

Ekspert i (te) pare kontabel i (te) autorizuar emerohet (n)

Z. Luan Kamberi

NENI 20

Asambleja e pergjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit me cilesine aksionerit te vetem.

NENI 21

Dispozita te fundit

Ne nje afat prej 6(gjashte) muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar drejtori I shoqerise do te jete drejtori I ishndermarrjes shteterore.

Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit, vec per shkaqe te perligjura.



NENI 22

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.





REPUBLIKA E SHQIPERISË
 UJËSJELLËSI SH.A. PEQIN
 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Nr. 5.prot.

Peqin më 02/03/2016

VENDIM

Nr. 4 date 02/03/2016

Për caktimin e ekspertit kontabël të autorizuar të Ujësjetllësit sh.a. Peqin

Mbeshtetur ne ligjin nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare", neni 135, pika 2, si dhe Statutin e Ujësjetllësit sh.a. Peqin, me propozim te Drejtorit të Përgjithshëm të Ujësjetllësit, Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve, ne mbledhjen e dates 02.03.2016i:

Vendosi:

1. Te miratojë propozimin për caktimin si ekspert kontabël te autorizuar të Ujësjetllësit sh.a. Peqin të Zj.Vjollca Jonuz Dervishi, me Nr.Liçense 39.
2. Në zbatim të nenit 43 dhe 44 të Ligjit nr.9723 dt 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të depozitohet ky vendim brënda afateve ligjore pranë QKR.
3. Ngarkohet me zbatimin e ketij vendimi Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjetllësit sh.a. Peqin.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

KRYETARI

/ Saimir HASALLA /



REPUBLIKA E SHQIPERISË
 UJËSJELLËSI SH.A. PEQIN
 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Nr. 4.prot.

Peqin më 02/03/2016

VENDIM

NR. 3, DATË 02/03/2016

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË UJËSJELLËSI SH.A.PEQIN

Mbeshtetur në Ligjin nr.139/2015 dt.17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" Ligjin nr.9901, dt.14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 135, shkronja b) dhe g) dhe neni 213, si dhe VKM nr.63, dt.27.1.2016 "Për riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura", pika 1 dhe pika 2, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, në mbledhjen e datës 02.03.2016;

VENDOSI :

1. Shoqeria Ujësjetllësi sh.a. Peqin organizohet si shoqëri aksionare, sipas sistemit me nje nivel administrimi dhe funksionon në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Miratimin e Statutit te Shoqërisë Ujësjetllësi sh.a.Peqin sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Në zbatim të nenit 43 dhe 44 të Ligjit nr.9723 dt 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të depozitohet ky vendim brënda afateve ligjore pranë QKR.
4. Ngarkohet me zbatimin e ketij vendimi Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjetllësit sh.a. Peqin
5. Vendimi nr. 1, datë 06.12.2015 "Për miratimin e Statutit të Ujësjetllësit sh.a.Peqin" dhe te gjithë aktet që bien ndesh me këtë vendim revokohen.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas sipas percaktimeve të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjes vendore" dhe ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

KRYETARI

/ Saimir HASALLA /



